

VENDIM
Nr. 538, datë 8.7.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR
GARANTIMIN E RREGULLIT E TË SIGURISË NË GJYKATA DHE PROKURORI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 2, të nenit 49, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i kriterëve dhe i procedurave lidhur me rregullin e sigurinë në ambientet e gjykatave dhe të prokurorisë, nëpërmjet të cilave synohet marrja e masave të destinuara, për:

a) mbrojtjen e personave, duke përfshirë magjistratët, punonjësit e administratës së gjykatës dhe të prokurorisë, palët në proces, personat e thirrur në proces, publikun dhe të gjithë përdoruesit e tjerë, nga aktet e agresionit apo nga aktet keqdashëse të vullnetshme;

b) sigurinë e tërësisë së ndërtesës së gjykatës dhe të prokurorisë, të të gjitha objekteve dhe pajisjeve të strehuara në to, duke përfshirë të gjitha hapësirat e jashtme që ndodhen në perimetrit e tyre, përfshirë edhe parkingun, nga rreziqet e zjarrit, elektrike, si dhe rreziqe të tjera të dëmtimit.

2. Rregullat mbi sigurinë dhe rregullin në gjykata e prokurori hartohen dhe zbatohen në përputhje me parimin e mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, të konfidencialitetit, të mosdiskriminimit, të garantimit të aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara, si dhe të aksesit të barabartë në drejtësi.

3. Rregullat e parashikuara në këtë vendim nuk duhet të cenojnë veprimtarinë gjyqësore dhe administrative të institucioneve përkatëse, si dhe zhvillimin në mënyrë transparente e publike të proceseve gjyqësore.

4. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) **“Punonjës sigurie”**, punonjësit e ngarkuar për të garantuar rendin dhe sigurinë në gjykata e prokurori, sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës në fuqi.

b) **“Gjykata”**, gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, Gjykata e Lartë, si dhe gjykatat e tjera të cilat krijohen me ligj, me përjashtim të gjykatave, siguria dhe rregulli i të cilave gjen rregullim të posaçëm.

c) **“Prokurori”**, prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë, pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të apelit dhe Prokuroria e Përgjithshme, me përjashtim të Prokurorisë së Posaçme.

ç) **“Kryetar”**, kryetari i gjykatës ose i prokurorisë, përfshirë kryetarin e Gjykatës së Lartë dhe Prokurorin e Përgjithshëm.

d) **“Këshillat”**:

i. Këshilli i Lartë Gjyqësor;

ii. Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

dh) **“Ambiente”**, përkatësisht, ambientet e brendshme të gjykatës apo të prokurorisë dhe trualli funksional përreth tyre, duke përfshirë pjesët e përbashkëta me ndërtesën kryesore, parkingun për automjetet, si dhe çdo objekt tjetër brenda perimetrit rrethues të godinës, që përdoret në funksion të ushtrimit të veprimtarisë të gjykatës dhe të prokurorisë.

e) **“Siguria e ambienteve”**, i referohet ndalimit të hyrjes së paligjshme, dëmtimit dhe kryerjes së akteve të dhunshme ndaj ambienteve, sjelljes së eksplozivëve, të armëve ose të

sendeve të tjera që mund të përdoren si armë ose çdo aktiviteti tjetër të paligjshëm ndaj ambienteve të gjykatës apo prokurorisë.

II. KRITERET PËR GARANTIMIN E RREGULLIT DHE TË SIGURISË NË GJYKATA E PROKURORI

1. Këshillat hartojnë politikën për rregullin dhe sigurinë, përkatësisht, në ambientet e gjykatës apo të prokurorisë, e cila është në përputhje me politikën e përgjithshme kombëtare dhe përcakton qartë objektivat e përgjithshëm në lidhje me rregullin e sigurinë, si dhe pasqyron angazhimet e marra për përmirësimin e performancës së tyre në çdo gjykatë e prokurori.

2. Kriteret që duhet të udhëheqin këshillat në garantimin e rregullit dhe të sigurisë në institucionet përkatëse lidhen me:

a) përgatitjen dhe përditësimin e programit për menaxhimin e rregullit e të sigurisë;
b) planifikimin e nevojave buxhetore në fushën e rregullit dhe të sigurisë;
c) përcaktimin e objektivave në fushën e rregullit e të sigurisë së ambienteve, si dhe në fushën e sigurisë në punë;

ç) përcaktimin e objektivave prioritarë të përmirësimit të performancës dhe të ndërhyrjeve në fushën e rregullit e të sigurisë;

d) kryerjen e diagnostikimeve të sigurisë ndaj zjarrit në gjykata dhe prokurori, me qëllim identifikimin e të gjitha rasteve të mospërputhjes me rregullat e mbrojtjes nga zjarri dhe propozimin e planeve të sigurimit të ndërtesave;

dh) hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit, për të përmirësuar parandalimin e rreziqeve të rënies së zjarrit, si dhe të planeve të emergjencave sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile;

e) marrjen e masave për vendosjen e pajisjeve të nevojshme për funksionimin, kontrollin dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë;

ë) përgatitjen dhe përditësimin e procedurave që mundësojnë ndërgjegjësimin dhe informimin në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e nëpunësve të gjykatës apo të prokurorisë dhe stafit administrativ;

f) marrjen e masave për përmirësimin në mënyrë të vazhdueshme të sigurisë së objekteve dhe sigurisë në punë dhe ofrimin e trajnimeve të detyrueshme për stafin e gjykatave e të prokurorisë në fushën e sigurisë;

g) rishikimin dhe kontrollin periodik të sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe mjeteve ekzistuese, me qëllim garantimin e përshtatshmërisë e të efikasitetit të tyre;

gj) vendosjen e rregullave e të procedurave në lidhje me ruajtjen dhe instalimin e pajisjeve të sigurisë, si dhe ruajtjen e shkatërrimin e dokumentacionit, të regjistrave fizikë ose elektronikë, të sistemeve dhe çdo mjeti ose pajisjeje tjetër, nëpërmjet të cilit administrohen dhe përpunohen të dhënat personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

h) përcaktimin e përgjegjësisë së aktorëve të ndryshëm të gjykatave e të prokurorisë, të ngarkuar me klasifikimin e informacioneve dhe përhapjen e tyre;

i) përcaktimin e rregullave e të masave në kuadër të garantimit të konfidencialitetit dhe të sigurisë të të dhënave personale që do të përpunohen gjatë implementimit të masave të sigurisë fizike.

3. Këshilli i gjykatës miraton rregulla të veçanta për çështje të ruajtjes dhe të sigurisë në gjykatë.

III. RREGULLAT E SIGURISË

Rregullat e sigurisë janë, si më poshtë vijon:

1. Sigurimi i ambienteve:

Ndërtesa e gjykatës dhe e prokurorisë ruhet me punonjës të sigurisë, për të garantuar ruajtjen e rregullit e të sigurisë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Hyrja në godinë:

a) hyrja e publikut në godinën e gjykatës apo të prokurorisë realizohet vetëm nëpërmjet hyrjes kryesore, pas verifikimit të dokumentit të identifikimit nga punonjësi i sigurisë;

b) hyrja kryesore e godinës së gjykatës apo të prokurorisë mbikëqyret nga një ose disa punonjës të sigurisë;

c) çdo person i nënshtrohet procedurave të kontrollit dhe të sigurisë në momentin e hyrjes në godinë;

ç) magjistratët, punonjësit e administratës së gjykatës dhe të prokurorisë, si dhe personat e autorizuar nga kryetari hyjnë në godinë nëpërmjet një hyrjeje të veçantë;

d) hyrja e personave të ndaluar apo të arrestuar, të paraburgosurve dhe të dënuarve të shoqëruar realizohet nëpërmjet hyrjes së veçantë për këto kategori;

dh) hyrjet e veçanta, sipas shkronjave “ç” dhe “d”, të kësaj pike, shërbejnë edhe si dalje emergjence në rastet kur jepet urdhër për evakuim nga kryetari.

3. Hyrja e automjeteve:

a) hyrja e automjeteve në dispozicion të gjykatës apo të prokurorisë, të automjeteve private të magjistratëve dhe të punonjësve të administratës, e mjeteve të cilat transportojnë të akuzuarit nga institucionet e paraburgimit dhe të dënuarit nga institucionet e vuajtjes së dënimit, për të marrë pjesë në seancë, si dhe të automjeteve të furnizimit dhe ofruesve të jashtëm të shërbimit, realizohet përmes portave të veçanta për hyrjen e këtyre automjeteve;

b) në raste të veçanta, sipas rastit, mund të lejohen të hyjnë edhe automjete të tjera, vetëm me autorizim paraprak të kryetarit;

c) Hapësira e parkimit rreth godinës së gjykatës apo të prokurorisë përdoret vetëm për automjetet e përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike;

ç) Hyrja e automjeteve mbikëqyret me punonjës sigurie.

4. Siguria në godinë:

a) Rregullat bazë të sigurisë që duhet të përmbushen nga çdo gjykatë dhe prokurori janë:

i. pajisja me detektorë elektronikë, që vendosen pranë hyrjes kryesore për diktimin e hyrjeve të paautorizuara;

ii. vendosja e pajisjeve të testuara për fikjen e zjarrit në ambientet e godinës së institucionit përkatës, si dhe sistemit të alarmit të zjarrit;

iii. pajisja me mjete të sigurisë (çelësa, karta hyrjeje apo mjete të tjera të kësaj natyre) e punonjësve të administratës të institucionit përkatës, me qëllim realizimin e hyrjes nëpërmjet hyrjes së veçantë të godinës së institucionit;

iv. pajisja me sistemin e kamerave të vëzhgimit të lidhura me detektorë alarmi dhe atë elektronik të lejimit të hyrjes në godinë, si dhe me server të ruajtjes së këtyre të dhënave për një periudhë deri në 2 muaj;

v. pajisja e dritareve me sistem elektronik detektimi, me sensorë apo detektorë;

vi. vendosja e sinjalistikës për vendkalimet e emergjencës që i mundësojnë personelit dhe publikut të dalë jashtë me shpejtësi;

b) informacioni i përmbledhur mbi rregullat bazë të sigurisë afishohet në një vend të dukshëm në ambientet hyrëse të institucionit përkatës;

c) gjykatat dhe prokuroritë përcaktojnë personat përgjegjës që do të kenë akses në sistemet e kamerave, si dhe vendosin rregulla specifike lidhur me përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me udhëzimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.

IV. PUNONJËSI I SIGURISË

1. Punonjësi i sigurisë garanton rregullin dhe sigurinë, në:

a) hyrjet kryesore dhe të veçanta të institucionit përkatës;

b) portat për hyrjen e automjeteve dhe hapësirën e parkimit;

c) sallën e gjyqit, nëse i kërkohet nga kryetari i seancës, në zbatim të urdhrave të dhënë prej tij;

ç) ambientet e tjera të brendshme, të cilat përfshijnë kryesisht korridoret lidhëse pranë zyrave, si dhe brenda perimetrit rrethues të godinës së institucionit përkatës.

2. Punonjësi i sigurisë ka uniformën e tij të veçantë, me qëllim evidentimin nga publiku, si dhe pajiset me mjet identifikimi, që përmban në mënyrë të dallueshme fotografinë e punonjësit, funksionin e tij dhe shenjën dalluese të subjektit të ofrimit të shërbimit të sigurisë.

3. Punonjësi i sigurisë është i detyruar të mbajë në vend të dukshëm mjetin e identifikimit, gjatë gjithë qëndrimit të tij në ambientet e institucionit përkatës.

4. Punonjësi i sigurisë mund të kontrollojë hyrjen e godinës apo automjetet dhe personat që dyshohen se përbëjnë rrezik për sigurinë e mjediseve, brenda një perimetri prej 5 metrash rreth godinës së institucionit përkatës, duke nisur prej vijës së objektit.

5. Procedura e verifikimit dhe e kontrollit të personave nga punonjësi i sigurisë konsiston dhe kryhet, si më poshtë vijon:

a) kontrolli i identitetit të personave që hyjnë ose qëndrojnë në ambientet e institucionit, nëpërmjet verifikimit të dokumentit të identifikimit të këtyre personave;

b) në rast se personi që hyn nuk posedon asnjë dokument identifikimi, identifikimi i tij mund të konfirmohet në një mënyrë tjetër të përshtatshme;

c) në rast se identiteti i personit nuk mund të konfirmohet, punonjësi i sigurisë nuk lejon hyrjen e tij në institucionin përkatës;

ç) kontrolli fizik i personave që hyjnë, qëndrojnë ose largohen nga ambientet e institucionit përkatës, si dhe i sendeve që zotërojnë apo mbajnë me vete;

d) kontrolli sipas shkronjës “ç”, të pikës 5, të këtij kreu, mund të bëhet nëpërmjet këqyrjes, prekjes sipërfaqësore ose duke përdorur mjete të tjera të përshtatshme, të tilla si detektorët;

dh) kontrolli që përfshin preken sipërfaqësore bëhet nga punonjësi i sigurisë me gjininë e njëjtë me personin që hyn, qëndron ose largohet nga ambientet e institucionit, përveçse në rastet kur nuk është e mundur kryerja e kontrollit aty për aty, në mënyrë të menjëhershme.

6. Regjistrimi i sendeve bëhet, si më poshtë vijon:

a) punonjësi i sigurisë ruan përkohësisht sende të personit, në vende të krijuara posaçërisht për këtë qëllim, me qëllim për të lejuar personin të hyjë në ambientet e institucionit;

b) regjistrimi i sendeve të mbajtura bëhet në formë të shkruar dhe me nënshkrimin e personit që posedon këtë send;

c) personi, i cili kundërshton mbajtjen e sendit/eve të ndaluar/a, nuk lejohet të hyjë në institucion;

ç) punonjësi i sigurisë mban përgjegjësi për ruajtjen e sendit gjatë kohës që personi qëndron në ambientet e institucionit përkatës dhe kthimin e sendit me shkrim në momentin e largimit nga institucioni.

7. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në ambientet e institucioneve përkatëse nuk lejohet mbajtja e sendeve, por pa u kufizuar vetëm në to, të përcaktuara, si më poshtë vijon:

a) armët, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për armët;

b) sende të mprehta ose me majë (duke përfshirë brisqe, gërrshërë, kaçavida ose çdo send tjetër të ngjashëm);

c) *spray* për mbrojtje;

ç) pranga;

d) kafshë;

dh) substanca narkotike e psikotrope;

e) çdo mjet tjetër që mund të përbëjë rrezik për sigurinë dhe rregullin në ambientet e institucionit.

8. Lista e sendeve të ndaluara, sipas pikës 7, të këtij kreu, afishohet në një vend të dukshëm në ambientet hyrëse të institucionit përkatës.

9. Në rastet kur mbajtja me vete e sendeve të ndaluara përbën vepër penale, punonjësi i sigurisë autorizohet të ndalojë mbajtësin e tyre dhe të njoftojë menjëherë Policinë e Shtetit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

10. Rregullat për sendet e ndaluara nuk zbatohen për:

a) personat, që mbajnë armë vetëm për shkak të funksionit dhe gjatë kryerjes së tij;

b) sende që përbëjnë provë materiale, për qëllime të gjyqimit.

11. Punonjësi i sigurisë, me qëllim ruajtjen e rregullit e të sigurisë në ambientet e institucionit përkatës, kryen detyrat e mëposhtme:

a) siguron ndalimin e hyrjes për personat, të cilët paraqesin rrezik për sigurinë e personave ose të godinës së institucionit përkatës;

b) ushtron kontroll personal nëpërmjet pajisjeve teknike dhe inspekton çantat e personave që hyjnë në ambientet e brendshme të institucionit;

c) merr masa për bllokimin e përkohshëm të sendeve, mbajtja dhe futja në institucion e të cilave është e ndaluar sipas këtij vendimi, me qëllim për të lejuar personin të hyjë në ambientet e institucionit përkatës;

ç) informon kryetarin e institucionit përkatës dhe, në mungesë të tij, kancelarin, për sjellje të dyshimta nga personat që ndodhen në ambientet e godinës së institucionit;

d) merr masat e nevojshme për kufizimin e qarkullimit të automjeteve të palejuara në hapësirat e parkimit, në bodrume, në garazhe, si dhe në oborrin e institucionit përkatës;

dh) përdor forcën fizike në përputhje dhe proporcion me rastet që e kanë diktuar atë dhe aq sa është e nevojshme për të shmangur apo neutralizuar situatën e rrezikut të krijuar;

e) raporton pranë kryetarit të institucionit përkatës dhe, në mungesë të tij, kancelarit, telefonatat që përmbajnë kërcënime të shprehura apo nënkuptojnë mundësinë e një rreziku real për magjistratët dhe/apo punonjësit e administratës së institucionit;

ë) jep udhëzime të shprehura, në zbatim të urdhrave të kryetarit të institucionit;

f) mban kontakte të vazhdueshme me institucione si policia, personeli i grupit të shoqërimit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, spitalet, zjarrfikëset dhe i raporton në mënyrë periodike kryetarin të institucionit përkatës;

g) ndërmer kontrollë rutinë për të gjitha pajisjet e sigurisë dhe i raporton kryetarin të institucionit përkatës në rast të mosfunksionimit të këtyre pajisjeve;

gj) vlerëson mjediset e prirura ndaj zjarrit dhe mbron personat, si dhe pasuritë nga rreziku i ndezjes apo shpërthimit së zjarrit;

h) kryen evakuimin e godinës, në zbatim të urdhrit verbal të kryetarit, sipas planeve të emergjencave të përcaktuara për rastet e evakuimit. Në rastet e rrezikut të madh e të menjëhershëm, evakuimi mund të kryhet edhe pa urdhër të kryetarit.

i) Informon menjëherë kryetarin, dhe në mungesë të tij kancelarin, si dhe strukturat policore për çdo ngjarje të rëndë që paraqet rrezik real dhe cenon sigurinë e institucionit përkatës, e cila konstatohet pas orarit zyrtar.

V. DREJTIMI I PERSONELIT TË SIGURISË

1. Kryetari i institucionit përkatës drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e punonjësit të sigurisë, e cila kryhet në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.

2. Në ushtrimin e funksioneve të tij, kryetari kryen këto detyra:

a) jep urdhra verbalë për evakuim:

i. në rast rreziku brenda godinës, që nuk mund të evitohet në mënyrë tjetër;

ii. në rast aktivizimi të sistemit të alarmit për rënien e zjarrit.

b) mban kontakte të herëpashershme me strukturat drejtuese policore, për të garantuar rregullin dhe sigurinë;

c) harton planet e veprimit për sigurimin e rregullit në institucion;

ç) krijon dhe përditëson një regjistër të sigurisë ndaj zjarrit, i cili përmban të gjitha informacionet e domosdoshme për sigurinë nga zjarri për ndërtesat e hapura për publikun dhe shërben si regjistër sigurie dhe si historik i parandalimit dhe fikjes së zjarreve;

d) merr masat për mbajtjen e pajisjeve teknike në gjendje funksionale dhe testimin sistematik të tyre;

dh) merr masat e nevojshme për furnizimin me energji elektrike në mënyrë të qëndrueshme dhe vendosjen e gjeneratorëve në vende të sigurta;

e) merr masat për sigurimin e mirëmbajtjes dhe të kontrollit të rregullt të sistemeve të informacionit;

ë) merr çdo masë tjetër të nevojshme për të garantuar rregullin dhe sigurinë në ambientet e institucionit përkatës.

3. Gjatë ushtrimit të detyrave të përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, me qëllim garantimin e rregullit e të sigurisë, kryetari ndihmohet nga kancelari për përmbushjen e tyre.

VI. RREGULLA TË FUNDIT

1. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi mbulohen, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

2. Ngarkohen Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kryetarët, si dhe kancelarët e gjykatave dhe të prokurorive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama